

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8287
E shtunë, 25 prill 2026
Çmimi 0.50 €

Kuvendi i Kosovës nderon Eliot Engelin, mikun besnik të lirisë dhe pavarësisë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ASHAK-u MBAN MBLEDHJE KOMEMORATIVE PËR AKADEMIK REXHEP QOSJEN, VLERËSOHET LART FIGURA E TIJ

FAQE 4-5



Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) është mbajtur të premtën mbledhje komemorativë në nderim të

jetës dhe veprës së akademik Rexhep Qosjes. Kryetarja e ASHAK-ut, Justina Shiroka-Pula, kryeministri Albin Kurti dhe përfaqësues të akademive

nga Kosova e Shqipëria vlerësuan kontributin e jashtëzakonshëm të Rexhep Qosjes në letërsi, shkencë dhe çështjen kombëtare



SULMI I BANJSKËS: SPASOJEVIQ DHE TOLLIQ DËNOHEN ME BURGIM TË PËRJETSHËM, MAKSIMOVIQ ME 30 VJET

F. 7



URIME DITËLINDJEN PRESIDENT, KOSOVA PRET KTHIMIN TUAJ SË BASHKU ME SHOKË

F. 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



FUNDJAVË E "NXEHTË" NË ELITËN E FUTBOLLIT TË KOSOVËS

F. 11

AKTUALE



TRUMPI NJOFTON SE ARMËPUSHIMI IZRAEL-LIBAN ËSHTË ZGJATUR PËR TRI JAVË

F. 2

WHITAKER I KËRKON SERBISË QË TË RRESHTOHET ME PERËNDIMIN

F. 2

KUVENDI RATIFIKON MARRËVESHJEN PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BORDIN E PAQES

F. 3

EKONOMI



KUVENDI MIRATON MARRËVESHJEN PËR PROGRAMIN IPA 2020

F. 8

67.1% MË SHUMË DENONCIME, ATK-JA INTENSIFIKON LUFTËN KUNDËR EVAZIONIT TATIMOR

F. 8

SPORT



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMPI NJOFTON SE ARMËPUSHIMI IZRAEL-LIBAN ËSHTË ZGJATUR PËR TRI JAVË

UASHINGTON, 24 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka njoftuar se armëpushimi mes Izraelit dhe Libanit është zgatur edhe për tri javë të tjera, pas takimit të tij me të dërguarit e dy vendeve të enjten vonë. Por, me gjithë armëpushimin, dhuna përgjatë kufirit Izrael-Liban ka vazhduar. "Takimi shkoi shumë mirë!", shkroi Trump në Truth Social të enjten vonë. "Shtetet e Bashkuara do të punojnë me Libanin për ta ndihmuar të mbrohet nga Hezbollahu. Armëpushimi mes Izraelit dhe Libanit do të zgjatet për tri javë", shtoi ai.

Armëpushimi ishte paraparë të përfundonte më 26 prill. Hezbollahu - i mbështetur nga Irani - është grup militant dhe parti politike njëkohësisht, dhe kontrollon pjesën më të madhe të Libanit jugor. Ai konsiderohet organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka futur në listë të zezë vetëm krahun e tij të armatosur. Qeveria e Libanit nuk është pjesëmarrëse aktive në konflikt dhe është zotuar se do ta çarmatosë Hezbollahun. Trumpi tha se pret "që së shpejti" t'i presë në një takim

kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, dhe presidentin e Libanit, Joseph Aoun. Trump, nënpresidenti JD Vance, dhe sekretari i shtetit Marco Rubio, së bashku me ambasadorët amerikanë në Izrael dhe Liban, ishin ndër ata që u takuan të enjten me "përfaqësues të rangut të lartë" të Izraelit dhe Libanit, sipas presidentit amerikan. Ambasadorja e Libanit në ShBA, Nada Hamadeh Moawad, dhe ambasadori i Izraelit në ShBA, Yechiel Leiter, përfaqësuan vendet e tyre në bisedime. Njoftimi i Trumpit erdhi edhe



pse dhuna u përshkallëzua pranë kufirit Izrael-Liban, me të dyja palët që qëlluan ndaj njëra-

tjetrës pas akuzave për shkelje të armëpushimit 10-ditor që kishte hyrë në fuqi më 16 prill.

WHITAKER I KËRKON SERBISË QË TË RRESHTOHET ME PERËNDIMIN

UASHINGTON, 24 PRILL - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në NATO, Matthew Whitaker, ka porositur se Serbia duhet të përmbahet nga bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me partnerë të pasigurt, duke theksuar se e ardhmja strategjike e Serbisë, duhet të jetë "e rreshtuar me Perëndimin". "Siguria varet nga zgjedhja e partnerëve të duhur", shkroi ai në X më 23 prill, duke theksuar se këtë mesazh ia përcolli presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, gjatë një takimi në Beograd të zhvilluar një ditë më parë. Serbia, as katër vjet pas fillimit të pushtimit rus të Ukrainës,



nuk i është bashkuar sanksioneve që Perëndimi ka vendosur ndaj Moskës për shkak të luftës. Po ashtu, Beogradi nuk ka hequr

dorë as nga lidhjet politike me përfaqësuesit e pushtetit në Rusi. Whitaker gjithashtu tha se me Vuçiqin ka pasur një takim konstruktiv për "nisjen e një

epoke të re në marrëdhëniet mes ShBA-së dhe Serbisë". "E vlerësojmë rolin e Serbisë në stabilitetin rajonal dhe presim me padurim stërvitjen e përbashkët të Serbisë dhe NATO-s në maj", tha ai. "Por, isha i qartë: bashkëpunimi i Serbisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me partnerë të pasigurt krijon varësi strategjike afatgjatë, nga e cila është e vështirë të çlirohesh, dhe e ndërlikon bashkëpunimin e ardhshëm", shtoi Whitaker. Më herët, Vuçiq ka thënë se me ambasadorin e ShBA-së në NATO ka diskutuar për çështjet e sigurisë dhe politikës rajonale dhe për raportet mes Beogradit dhe Uashingtonit.

Agjencitë amerikane të inteligjencës kanë paralajmëruar në raportin e tyre vjetor se Ballkani Perëndimor mbetet një zonë me tensione të shtuara politike dhe ndikime të jashtme, duke vënë në pah veçmas rolin e Rusisë në destabilizimin e rajonit. Në raportin e publikuar më 18 mars u tha lufta në Ukrainë ka thelluar ndarjet mes Perëndimit dhe Moskës, gjë që reflektohet edhe në Ballkan. Sipas raportit, Rusia "nxit paqëndrueshmëri mes Serbisë, të cilën e favorizon, dhe Kosovës", si dhe "mbështet shkëputjen e entitetit Republika Sërpska nga Bosnja dhe Hercegovina".

NETANYAHU DIAGNOSTIKOHET ME KANCER NË FAZË TË HERSHME

JERUSALEM, 24 PRILL - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu iu nënshtrua në heshnje trajtimit për kancerin e prostatës, njoftoi vetë ai, ndërsa publikoi rezultatet e ekzaminimit të tij vjetor mjekësor. Netanyahu, 76 vjeç, tha se e vonoi publikimin e raportit të tij vjetor mjekësor, i cili zbuloi se ai ishte diagnostikuar me kancer për herë të parë - me dy muaj në mënyrë që të mos përdorej si propagandë nga Irani. Udhëheqësi me mandatin më të gjatë në historinë e Izraelit iu

nënshtroja një operacioni në dhjetor të 2024-s, një operacion që Zyra e Kryeministrit e bëri të ditur publikisht në atë kohë. Në kontrollin e fundit pas operacionit, Netanyahu deklaroi se mjekët zbuluan një tumor malinj në prostatën e tij me madhësi më të vogël se një centimetër. Zyra e Kryeministrit publikoi gjithashtu dy letra nga mjekët e tij për të shoqëruar zbulimin. Ai nuk thotë se kur ka qenë kontrolli i fundit, por një burim

izraelit i njohur me çështjen i tha CNN-së se kanceri u diagnostikua disa muaj më parë. Ndryshe, Netanyahu filloi t'i nënshtrohej radioterapisë rreth dy muaj e gjysmë më parë, sipas burimit, dhe e kishte përfunduar së fundmi trajtimin. Lideri izraelit thotë se mori vendimin për t'iu nënshtroar radioterapisë dhe "njolla u zhdruk plotësisht". "Falë Zotit, jam mirë", shkroi ai në X. "Pata një problem të vogël mjekësor me prostatën që u trajtua plotësisht", shtoi ai.



Macroni: Nuk do të merrem me politikë pas vitit 2027

PARIS, 24 PRILL - Emmanuel Macron ka deklaruar se nuk do të mbetet në politikë pasi të largohet nga Pallati Elysee në vitin 2027, kur t'i përfundojnë dy mandatet maksimale. "Unë nuk kam qenë i përfshirë në politikë para [se të bëhesha

president] dhe nuk do të jem i përfshirë as më pas", tha presidenti francez para studentëve në Nikosia, gjatë një vizite dyditore në Qipro për një takim të Këshilli Evropian. I zgjedhur në vitin 2017 në moshën 39-vjeçare, Macron u

bë presidenti më i ri i Francës që nga themelimi i Republikës së Pestë Franceze në vitin 1958. Ai u rizgjedh në vitin 2022, por nuk mund të kandidojë për një mandat të tretë në zgjedhjet presidenciale të vitit të

ardhshëm, shkruajnë mediat e huaja. Macron, i cili ka shërbyer edhe si ministër i ekonomisë nga viti 2014 deri më 2016 nën qeverinë socialiste të François Hollande, nuk dha detaje për hapat e tij të ardhshëm.

KUVENDI RATIFIKON MARRËVESHJEN PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BORDIN E PAQES

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 PRILL - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë ratifikuar të premtën marrëveshjen ndërkombëtare për anëtarësimin e Kosovës në Bordin e Paqes, nismës së presidentit amerikan, Donald Trump, për zgjidhjen e konflikteve në botë. Për marrëveshjen votuan 103 deputetë, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Haxhi Avdyli nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje tha se anëtarësimi i Kosovës në Bordin e Paqes është hap me rëndësi strategjike për vendin. "Anëtarësimi është një vendim i rëndësishëm politik, dhe strategjik që e pozicionon vendin tonë si kontribuues aktiv në ndërtimin e paqes globale dhe sigurisë ndërkombëtare", tha ai. Edhe partitë opozitare thanë se anëtarësimi i Kosovës në këtë bord është në interes të vendit. "Anëtarësimi është interes i lartë shtetëror, forcon sigurinë ndërkombëtare, orientimin euroatlantik të Kosovës dhe konsolidon aleancën me ShBA-në", tha deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës në opozitë, Elmi Reçica.

Sipas deputetit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Anton Quni, tha se Kosova po shndërrohet në eksportuese të stabilitetit, duke shtuar se kjo është mundësi për vendin që të formësojë imazhin në botë. "Ne nuk po votojmë thjesht për një anëtarësim, po votojmë për dinjitetin e shtetit tonë, për jetësimin e miqësive tona të



shenjta", tha ai.

Ndërkaq, Time Kadrijaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës tha se anëtarësimi në nismën e presidentit Trump, është dëshmi se vendi po garanton siguri dhe po forcon miqësinë me ShBA-në. "Vetë ky anëtarësim dhe votimi i sotëm është një garanci për Kosovën", tha ajo.

Çfarë është Bordi i Paqes?

Më 22 janar, është themeluar Bordi i Paqes gjatë një ceremonie të mbajtur në Davos të Zvicrës. Bordi u lansua nga presidenti amerikan, Donald Trump, si një trup i ri për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ishte ndër themelueset e Bordit të Paqes dhe e ka përkrahur plotësisht nismën e Trumpit. Ky trup i ri fillimisht ishte i përqendruar në zbatimin e

marrëveshjes për përfundimin e luftës Izrael-Gazë, ashtu siç është miratuar nëntorin e vitit të kaluar me Rezolutën 2803 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Por, Karta e Bordit nuk e kufizon rolin vetëm në Gazë.

Bordi do të udhëhiqet nga Trumpi, ndërkaq ai do të ketë edhe Bordin Ekzekutiv ku janë emëruar si anëtarë: sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i dërguari i posaçëm i Trumpit, Steve Witkoff, dhëndri i presidentit amerikan, Jared Kushner, ish-kryeministri britanik, Tony Blair, miliarderi Mark Rowan, biznesmeni amerikan Ajay Banga dhe këshilltari për siguri kombëtare i ShBA-së, Robert Gabriel. Ndërkaq, Nickolay Mladenov, politikan bullgar do të jetë përfaqësues i Bordit të Paqes në Gazë.

Ndërkaq, si mekanizëm i Bordit të

Paqes është krijuar edhe Forca Ndërkombëtare Stabilizuese, përmes së cilit Kosova do të dërgojë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Gazë, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e armëpushimit në Rripin e Gazës.

Kjo forcë për Gazën është pjesë e planit 20-pikësh të Trumpit për të arritur paqe në Gazë.

Plani është pranuar në tetorin e vitit të kaluar nga Izraeli dhe Hamasi – grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian. Lufta në Gazë nisi në tetor të vitit 2023, pas sulmit të Hamasit ndaj Izraelit, kur u vranë mbi 1.200 njerëz në Izrael dhe mori qindra pengje.

Sulmet hakmarrëse izraelite në Gazë shkaktuan mijëra të vrarë, krizë urie dhe dëme të mëdha infrastrukturore.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar dërgimin e trupave, ndërkaq më

pas ushtruesja e presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka autorizuar dërgimin e FSK-së në Gazë.

Osmani: Kuvendi vulosi anëtarësimin e Kosovës në Bordin e Paqes

Ish-presidentja Vjosa Osmani ka reaguar pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë ratifikuar marrëveshjen ndërkombëtare për anëtarësimin e Kosovës në Bordin e Paqes.

Ajo ka shkruar në "Facebook" se Kuvendi i Kosovës vulosi një moment historik duke ratifikuar marrëveshjen për anëtarësimin e Kosovës në Bordin e Paqes. "Është një hap i madh që forcon subjektivitetin tonë ndërkombëtar dhe e vendos Republikën e Kosovës aty ku e meriton: krahe për krahe me Amerikën dhe në mesin e shteteve që kontribuojnë për paqen globale. Ishin Tomahawk-ët amerikanë që, në vitin 1999, çanë errësirën dhe ndalën makinerinë gjencidale serbe mbi popullin tonë. Ishte Amerika ajo që qëndroi në anën e drejtësisë, kur ne kishim më shumë nevojë se kurrë për shpresë dhe shpëtim. Dhe është Amerika përsëri sot, ajo që qëndron përkrah nesh. Faleminderit ShBA-ve dhe presidentit Trump për besimin dhe ftesën që të jemi shtet themelues i Bordit të Paqes. Zoti e bekoftë Kosovën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës!", ka shkruar Osmani.

URIME DITËLINDJEN PRESIDENT, KOSOVA PRET KTHIMIN TUAJ SË BASHKU ME SHOKË

PRISHTINË, 24 PRILL - Të premtën ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shënuar ditëlindjen e 58-të. Edhe një ditëlindje larg Kosovës.

Afër gjashtë vite paraburgim në Hagë kanë shënuar një nga proceset më të gjata dhe më të ndjeshme për qytetarët dhe shtetin tonë.

Gjykimi tashmë ka përfunduar dhe vendi po e pret vendimin e trupit gjyqës. Pritja është për një vendim të drejtë dhe të mbështetur vetëm në fakte.

Kosova e pret kthimin e tij. Familja e pret. E presin edhe bashkëpunëtorët dhe qytetarët që e vlerësojnë kontributin e tij në luftën për liri, përkushtimin për paqe, shpalljen e pavarësisë dhe shtetndërtimin e Kosovës si shtëpi të përbashkët për të gjithë. Kjo pranverë duhet të jetë pranverë e drejtësisë.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, me rastin e ditëlindjes së Thaçit, ka shkruar në "Facebook", duke

theksuar se ish-presidenti po feston edhe një ditëlindje larg Kosovës. "E gjashta me radhë, President. Jo si zgjedhje, por si një padrejtësi që ka zgjatur shumë. Megjithatë, ka diçka që nuk është zbehur e as lëkundur asnjë ditë: qëndrueshmëria jote dhe besimi e krenaria jonë. Na ke munguar shumë. Tani është koha të ritakohemi dhe të festojmë në atdhe. Kosova të pret. Ne të presim. Urime ditëlindjen, President!", ka shkruar Hamza.

Edhe deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj, ka uruar Thaçin për ditëlindjen e 58-të. "Të urova para një viti me bindjen se një vit më vonë do të jeni të lirë, e sot po shpresoj se jeni në prag të fitores së fundit për liri", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, deputeti, dhe bashkëpunëtori më i afërt i tij, Enver Hoxhaj, duke e uruar për ditëlindjen, ka shkruar: "Urime ditëlindjen e 58-të miku im! Kosova të pret".





ASHAK-U MBAN MBLEDHJE KOMEMORATIVE PËR AKADEMIK REXHEP QOSJEN, VLERËSOHET LART FIGURA E TIJ

Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) është mbajtur të premten mbledhje komemorative në nderim të jetës dhe veprës së akademik Rexhep Qosjes. Kryetarja e ASHAK-ut, Justina Shiroka-Pula, kryeministri Albin Kurti dhe përfaqësues të akademive nga Kosova e Shqipëria vlerësuan kontributin e jashtëzakonshëm të Rexhep Qosjes në letërsi, shkencë dhe çështjen kombëtare

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 24 PRILL - Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), të premten u mbajt mbledhje komemorative me rastin e vdekjes së akademikut Rexhep Qosja. Komemoracionin e hapi kryetarja e ASHAK-ut, akademike Justina Shiroka-Pula, e cila fillimisht i ftoj të gjithë të pranishmit për një minutë heshtje. Kryetarja Shiroka-Pula, në fjalën hyrëse e vlerësoi lartë figurën e akademik Rexhep Qosjes dhe shprehu ngushëllime për familjen, kolegët dhe mbarë vendin. Në vazhdim fjalë rasti mbajti kryeministri Albin Kurti, i cili në fjalën e tij, vlerësoi lartë figurën e akademik Qosjes,

kontributin e tij në historinë e letërsisë shqipe, si dhe rolin dhe kontributin e tij për vendin në të gjitha kohërat. Në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, fjalë rasti mbajti akademike Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së e cila përcolli ngushëllimet e kryetarit të ASHSH-së, akademik Skender Gjinushit, të Kryesisë dhe të Asamblesë së ASHSH-së. Për jetën dhe veprën e akademik Rexhep Qosjes, foli edhe akademik Ali Aliu. Po ashtu, të premten në hollin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për nder të jetës dhe veprës së akademikut të ndjerë, Rexhep Qosja, liderë të institucioneve të vendit, partive politike, akademikë, profesorë dhe shkrimtarë kanë bërë homazhe dhe janë shkruar në librin e zisë.



Justina Shiroka-Pula:
Akademik Qosja ishte më shumë se një shkrimtar

Me ndjenë të thellë dhe me përgjegjësi institucionale, qëndrojmë të bashkuar në dhimbje për të nderuar jetën, veprën dhe për t'i dhënë lamtumirën e fundit një prej figurave të rëndësishme të kulturës dhe mendimit shqiptar, akademik Rexhep

Qosja. Në këto çaste përkujtimi, në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë jetën, veprën dhe personalitetin e tij. I përjetshëm qoftë kujtimi i akademik Rexhep Qosjes! Lavdi jetës dhe veprës së tij! Akademik Qosja ishte më shumë se një shkrimtar. Ai ishte një institucion në vetvete, një zë i fuqishëm i arsyes, kritike dhe një mbrojtës i palëkundur i së vërtetës. Humbja e tij nuk është vetëm humbje e letërsisë dhe kulturës sonë. Ajo përbën një humbje të madhe kombëtare, një zbrazëti që prek ndërgjegjen intelektuale të të gjithë shqiptarëve, ku do të qëndronin. Veprimtaria tij shumë dimensionale si studiues, shkrimtar, kritik, letrar dhe mendimtar publik përfaqëson arritje të rëndësishme të kulturës shqiptare bashkëkohore. Ai ndërtoi një opus të gjerë dhe të qëndrueshëm, i cili jo vetëm pasuroi fondin tonë shkencor e letrarë, por edhe kontribuoi në

formësimin e vetëdijes sonë kombëtare në periudha vendimtare historike. Trashëgimia e tij le pas mbetet një udhërrëfyes i çmuar, një pasuri e mendimit, e krijimtarisë dhe integritetit që do të vazhdojë të frymëzojë breza që vijnë. Vepra e tij do të vazhdojë të jetë si një referues i rëndësishëm i dijes dhe si një burim frymëzimi për studiuesit, krijuesit dhe të gjithë ata që besojnë në fuqinë e mendimit të lirë. Akademik Qosja mishëroi në mënyrë të denjë figurën intelektuale të angazhuar, të përkushtuar ndaj së vërtetës dhe të pa të palëkundur në mbrojtjen e vlerave themelore të shoqërisë. Ai mbeti gjithmonë konsekuent në mendimin e tij, duke dëshmuar integritet të lartë dhe guxim qytetar edhe në rrethanat kur fjala e lirë kërkonte sakrifi - Institucionet krijuese si këto e çmojnë lartë kontributin e tij në zhvillimin e letërsisë dhe të mendimit kritik, si dhe rolin e tij në afirmimin e vlerave kulturore shqiptare në hapësirën

kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë çast të rëndë shpreh ngushëllimet më të thella dhe më të sinqerta për familjen Qosja, për kolegët dhe për të gjithë komunitetin akademik e kulturor shqiptar. Le të jetë ky përkujtim jo vetëm një akt nderimi, por edhe një ripërtëritje e përkushtimit tonë për vlerat që ai përfaqësoi. I përjetshëm qoftë krijim-krijimtarja akademik Rexhep Qosjes! Ftoj kryeministrin Kurti për një fjalë. Kryeministër, fjala për ju.



Albin Kurti: Qosja nuk i druhej polemikës, ai ishte luftëtar i penës, artikulues i palodhur i ideve dhe këmbëngulës në mendimet e veta

E nderuara znj. Justina Shiroka - Pula, kryetare e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Të nderuar profesorë e akademikë, nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Shqipërisë, Të nderuar ministra, deputetë, përfaqësues të institucioneve vendore, Të dashur miq, kolegë e bashkëpunëtorë, Vepra e Rexhep Qosjes është një nga arritjet më të rëndësishme të mendimit kritik dhe kulturës shqiptare në shekullin XX dhe XXI. Ai u dallua si kritik letrar, eseist dhe intelektual publik, duke kontribuar në mënyrë të thellë me analizën e identitetit kombëtar, historisë dhe zhvillimit të letërsisë shqipe. Ai mbrojti vazhdimisht rëndësinë e kulturës si bazë të vetëdijes kombëtare dhe si instrument për emancipim shoqëror, duke ndikuar në formimin intelektual të brezave të tërë në hapësirën shqiptare.

Rexhep Qosja ishte modeli i intelektualit publik. Puna e tij shkencore ishte e pandarë nga angazhimi për identitetin kombëtar, shtetësinë e Kosovës dhe bashkimin shqiptar. Studimet e tij për Rilindësit, sidomos vepra "Porosia e Madhe", kushtuar poetit tonë kombëtar, Naim Frashërit, apo studimet për Asdrenin e të tjera, ndihmuan jashtëzakonisht shumë në formimin kombëtar të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi. Studimet e Rexhep Qosjes dhe të kolegëve të tij për gjuhën, letërsinë, historinë, folklorin shqiptar, përgatiten dy breza të

shqiptarëve për përballjen politike dhe shoqërore që do të vinte në dekadat 1980 e më pas 1990, për mbrojtjen e të drejtave dhe të dinjitetit kombëtar.

Kur nisi shpërbërja e Jugosllavisë dhe u shtua shtypja mbi shqiptarët, Rexhep Qosja u bë zëri më i spikatur akademik e intelektual shqiptar. Ai denoncoi në shtypin jugosllav dhe ndërkombëtar gënjeshtat dhe propagandën e atyre intelektualëve serbë, që do të shkruanin e përkrahnin memorandumun famëkeq të akademisë serbe nga viti 1986 dhe që përgatitën terrenin për gjenocidet, që Serbia do t'i ndërmerre në vitet e '90-ta. Ai u bë zëdhënësi i "Popullit të ndaluar", siç titullohej një prej veprave të tij të shumta dhe kjo ishte një përmbledhje e polemikave të tij me intelektualët jugosllavë të kohës.

Profesor Rexhep Qosja frymëzoi breza studentësh, i dha guxim e zë drejtësisë së protestave studentore të vitit 1981, që u bënë edhe demonstrata gjithëpopullore, e madje posaçërisht kur vala e tyre dukej se kishte rënë.

Në vitin 1985 ai rikonfirmoi brenda vetë atij sistemi, pra në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë në Novi Sad, në prill të vitit 1985, shtypjen që ushtrohej nga regjimi serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve. Aty, ai u foli pjesëmarrësve në gjuhën e tyre, siç tha, "jo nga frika se mos e quanin autoqefal, por që ta kuptonin të gjithë", sepse në gjuhën e tyre ai do të shpaloste megjithatë qenien shqiptare dhe gjendjen e trupit e të shpirtit të saj. Aty, ai demaskoi procesin e diferencimit të ushtruar nga Lidhja e Komunistëve me ndihmën e shërbimeve sekrete e të aparatit të dhunës.

Mes 14 pikave se çka domethënë me qenë intelektual shqiptar në Kosovë, ai thekson se, "kjo do të thotë, me iu frikësu fjalës diferencim, po aq sa intelektualët e mesjetës i frikësoheshin fjalës inkuizicion".

Qosja nuk i druhej polemikës, ai ishte luftëtar i penës, artikulues i palodhur i ideve



dhe këmbëngulës në mendimet e veta. Ai shkruante dhe fliste për zhvillimet politike në trojet shqiptare si për qëndresën paqësore në Kosovë, si për zhvillimet demokratike në Shqipëri e në Maqedoni të Veriut. Ai argumentonte se rilindja demokratike e shqiptarëve pas rënies së regjimeve komuniste dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, kishte plot pikëtakime me Rilindjen tonë Kombëtare dhe se tani, si atëherë, duheshin synuar si zgjidhja e drejtë e çështjes shqiptare, po ashtu edhe orientimi ynë për nga qytetërimi perëndimor. Në këtë kuptim, shkrimet e Qosjes hedhin bazat për një rilindje të tretë demokratike shqiptare në shekullin tonë, sepse, siç shkruante ai në vitin 1991: "çështja shqiptare, është çështje proces, e cila kushtëzohet prej rrethanash politike, ideologjike dhe ekonomike, të cilat janë ballkanike, por edhe evropiane".

Mendoj se majat e publicistikës së tij, Rexhep Qosja i kapi gjatë viteve 1990-2000, që ishin të mbushura me ngjarje domethënëse për shqiptarët. Ai ishte protagonist në disa prej këtyre ngjarjeve dhe dha ndihmesën e tij për dendësimin e historisë sonë

dhe siç ka shkruar, po citoj: "ne jemi të detyruar ta dendësojmë historinë, sepse sadopak shkurtohet rruga jonë drejt lirisë".

Me porosi të mëdha si kjo, Rexhep Qosja do të jetë figurë orientuese për shqiptarët, duke frymëzuar reflektime dhe angazhime në raport me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e kombit.

Ngushëllime të gjithëve, e u prehtë në paqe akademik, profesor Rexhep Qosja! Ju faleminderit!

Anila Hoda, akademike nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë: Qosja ishte një erudit i rrallë, një personalitet i jashtëzakonshëm i kulturës mbarëshqiptare

E nderuar kryetare Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademike Justina Shiroka-Pula,

I nderuar kryeministër i Republikë së Kosovës, zoti Albin Kurti,

Të nderuar akademikë dhe akademikë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,

Të nderuar familjarë, miq, koleg, pjesëmarrës.

Në emër të Kryesisë akademisë së shkencave, të Asamblesë të saj dhe tërë komunitetit shkencor në Shqipëri, kam nderin dhe njëkohësisht me dhimbje të thellë t'ju përcjell ngushëllime tona për ndarjen nga jeta të akademikut Rexhep Qosja, një prej figurave më të shquara të mendimit shkencor, letrar dhe kombëtar shqiptar.

Akademik Rexhep Qosja ishte një erudit i rrallë, një personalitet i jashtëzakonshëm i kulturës mbarëshqiptare,

si përkushtuar dhe shkrimtar i mirënjohur. Jeta dhe vepra e ti janë të lidhura pazgjidhshmërisht me historinë e mendimit shkencor, letrar dhe politik të botës shqiptare. Për më shumë se gjysmë shekulli, ai ishte një zë i fuqishëm në jetën intelektuale dhe publike dhe u shndërruar në një nga figurat më përfaqësuese të vetëdijes sonë kombëtare. Ai njihet gjerësisht si një nga zërat më të fort në debatet publike shqiptare, duke trajtuar me guxim dhe përgjegjësi çështje themelore të identitetit kombëtar, historisë, kulturës dhe zhvillimeve politike në Kosovë e Shqipëri. Angazhimi i tij qytetar dhe atdhetar për demokracinë, shtetin ligjor dhe marrëdhëniet ndërshtetërore u shpreh përmes një veprimtarie të gjerë shkencore e publicistike. Si drejtues i Institutit Albanologjik të Prishtinës, profesor Rexhep Qosja kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin e albanologjisë dhe në artikullimin e ideve për zhvillimin e kapaciteteve dhe identitetit kulturor të shqiptarëve në Kosovë dhe Shqipëri. Si profesor në Universitetin e Prishtinës, ai dha një kontribut të shquar në zhvillimin e shkencës moderne, duke dhënë një kontribut të vyer në jetën akademike dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor.

Po aq e rëndësishme është edhe krijimtaria e tij letrare, e



cila dëshmon për lidhjet e thellë, për artistike dhe vizion modern, ku trajtohen në mënyrë shumë dimensionale temat kombëtare dhe ato shoqërore. Angazhimi i tij në çështjen kombëtare dhe he në afirmimin ndërkombëtar të Kosovës është i pashembullt. Pjesëmarrja në Konferencën e Rambujesë si anëtar i delegacionit shqiptar, si dhe roli i tij në argumentimin dhe përfaqësimin e qëndrimeve shqiptare në një moment vendimtar historik dëshmojnë për kontributin e tij të drejtë për drejtë në procese që përcaktuan zhvillimet e mëtejshme për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Në vlerësim të këtij kontributi kolosal, Akademia e Shkencave Shqiptarisë ka patur nderin të zgjedhë anëtarë të jashtëm të sajë. Si shenjë mirënjohje për rolin, ndikimin e tij të shquar në zhvillimin e shkencës, dijes e të kulturës në Shqipëri. Ndaj në këto momente dhimbje e humbje të pazëvendësueshme, ne ndajmë dhimbjen me familjen e tij, me kolegët dhe gjithë komunitetin akademik e kulturor në Kosovë e më gjerë. Kujtimi, vepra dhe kontributi i akademik Rexhep Qosjes do të mbeten të përhershme në fondin e kulturës dhe të shkencës shqiptare dhe në ndërgjegjen kolektive të kombit tonë.

Ju lutem pranoni ngushëllimet më të sinqerta të kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademik Skënder Gjinushi, të Kryesisë së saj dhe të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Të paharruara qofshin veprat dhe kujtimi i akademik Rexhep Qosjes. Faleminderit.



Akademik Ali Aliu: Trashëgimia intelektuale dhe krijimtaria e Qosjes padyshim do të jetë objekt studimi në të ardhmen

Të nderuar pranishëm;
Jemi mbledhur sot për të nderuar jetën dhe veprën e akademik Rexhep Qosjes, i cili duke vijuar vizionin e rilindësve kombëtarë, i krijoi dhe i rikrijoi idetë moderne të integralistit nacional, të përfaqësuar në veprën e tij madhore studimore, shoqërore dhe politike. Akademik Rexhep Qosja, pa dyshim, me jetën e tij, zë vend të veçantë në historinë kombëtare, si njëra nga figurat qendrore e mendimit dhe veprimtarisë politike dhe kulturore dhe politike. Akademik Rexhep Qosja u përfshi edhe në çështjet nacionale, unifikimin e kombit duke nisur nga zhvillimi emancipues gjuhësor, shpirtëror, letrar e politik. Akademik Rexhep Qosja lindi në 1938 në Vuthaj të Malit të Zi, 4 klasat fillore i kreu në vendlindje, ndërsa maturën në Guci. Në vitin 1959 kreu shkollën normale në Prishtinë, ndërsa në vitin 1968 nisi studimet në Degën e Gjuhëve Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, të cilat i

kreu në vitin 1964. Në vitin 1967 u pranua asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ndërsa gjatë viteve 1967-1968 ndoqi studimet specializuara teknike, teori-letrare në Universitetin e Beogradit. Duke vijuar punën kërkimore shkencore në Institutin Albanologjik në vitin 1971 mbrojti tezën e doktoratës për jetën dhe krijimtarinë e Arzenit. Pas doktorimit Qosja në vitin 1972 u zgjodh bashkëpunëtor i lartë e pastaj këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, njëkohësisht profesor indorinar dhe ordinar në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Ishte drejtor i Institutit Albanologjik prej viti 1972 deri në vitin 1981 si dhe shef i Degës së Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik. Në vitin 1976 u bë anëtar i Akademisë Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Akademik Rexhep Qosja që në vitet e të dhjetë shekullit njëzet tashmë autor me autoritet i formuar intelektual, kur po niste vala e nacionalizmit hegjemonist serb, u shtua zëri tij i artikullar dhe kundërshtues ndaj ksenofobisë serbomadhe dhe u vu në mbrojtje të drejtave dhe të aspiratave shqiptare për liri. Veprimtaria në letrare dhe mendimi në tij autentik për zhvillimet e hovshme dhe të ndërlikuara në botën politike shqiptare nuk i pushoi asnjëherë, duke qenë herë prirës e herë alternativ i koncepteve ideologjike shqiptare me synimin final për çlirimin, progresin dhe integrimin shqiptar. Rexhep Qosja, mbi gjitha kombit shqiptar i la trashëgimi të përhershme veprën letrare e cila

qëndron e botuar në më shumë se 30 libra studimorë, teorik letrarë, të kritikës letrare, proza artistike në format e romanit, tregimit dhe të dramës, si dhe një numër të madh të shkrimeve publicistike, polemike e po ashtu të kujtesës individuale në formën e ditarëve e cila shndërrohet në kujtesë të historisë kulturore. Një politikë zhvillimit modern të botës shqiptare. Rexhep Qosja, duke qenë një nga prijësit e mendimit të konsoliduar për fenomenet kulturore, identitare letrare shqiptare, studimore albanologjike, në veçanti studimet letrare i ngriti në nivele reagimesh elementare për t'i dhënë peshë leximit, botimit dhe studimit sistematik në korpusin e ti letrar për të arritur deri te veprat kanonizueset të historisë letërsisë shqipe. Në këtë rast, i veçojmë veprat studimore letrare, dialogje me shkrimtarët, panteoni i radhuar, prej tipologjisë, deri te periodizimi, të cilat përfaqësojnë konceptin teorik dhe botëkuptimor të Rexhep Qosjes për letërsinë, i cili në thelb e ruan vlerësimin e gjykimin letrar në format qenësore nga interpretimi i veprave të veçanta e mbarimi në tipologji, zhanre historike e letrare. Kapërcimi nga bota e studimit të letërsisë shqipe në shkrimin krijues, në formën e prozës, Rexhep Qosja e bën me tregime romanin "Vdekja me vjen prej syve të tillë" në të cilin refuzohet kontrolli, diktati, survejimi në formë implicite kërkohet liria krijuese, si rrjedhojë normale njerëzore. Ndërsa në dramatik të veprave të tij, "Mite të zhveshura",

Rexhep Qosja shkruan dramën e ideve për format e tragjikes etnike dhe të alegorisë moderne politike. Rexhep Qosja, kapërcimin e madh studimor e bën me korpusin e "Historia e Letërsisë Shqipe" 1, 2 dhe 3 vëllime nga viti 34-39, vepër që sublimon punën e tij shumëvjeçare në studimin historik të letërsisë shqipe mbi parimin e historisë së letërsisë, duhet të përmbaj shkrimtarë e vepra që kanë vlerë historike për kohën e shfaqjes, ndikimin kulturor dhe estetik të saj. Amza e stilit krimor në prozën letrare do të mbetet "Vepra e vdekja me vjen të tilla", pra, sinkronizimi i formave shkrimore me mbizotërimin e ironisë, por tashmë me dallueshmëri tematike në varësi të perceptimeve të kontekstit të ri sociologjik, i cili e predisponon tekstin letrar. Shembull të ironisë postmoderne e cila në ambientin kulturor të Kosovës u shfaqën në fillim të shekullit 21-të janë romanet multiformale, multiideore, "Bijtë e Askujt", "Të fshehta të treguara", etj., në të cilat dominon tematika e fikcionalizimit të koncepteve ideologjike të lidhura me situata e akte politike. Përmendëm vetëm disa nga veprat studimore letrare të akademik Rexhep Qosjes. Trashëgimia e tij intelektuale, krijimtaria pa dyshim do të jetë objekt studimi në të ardhmen. Duke besuar se Rexhep Qosja, pra vepra jetësore, intelektual, krijimtare dhe nacionale e tij do të qëndroj në panteonin e kombit, theksojmë: qoftë i paharruar emri i tij. Ju faleminderit.



KUVENDI I KOSOVËS NDERON ELIOT ENGEL, MIKUN BESNIK TË LIRISË DHE PAVARËSISË

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 PRILL - Kuvendi i Republikës së Kosovës, i drejtuar nga kryetarja Albulena Haxhiu, mbajti të premtën një seancë të veçantë në shenjë nderimi për kongresistin amerikan Eliot Engel.

Në nderim të kongresistit amerikan, i cili ndërroi jetë më 10 prill, seanca u hap me një minutë heshtje.

Më pas, një fjalë rasti për nder të Eliot Engel mbajti kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu. Në fjalën e saj para deputetëve dhe mysafirëve në sallën plenare, ajo tha se sot po kujtohet e nderohet një njeri që la gjurmë të pashlyeshme në historinë e Kosovës. "Sot nderojmë e kujtojmë mikun besnik, por edhe ligjvënësin e drejtë amerikan, i cili në ditët më të vështira të historisë sonë të re, bashkë me shumë kongresistë dhe senatorë të tjerë amerikanë, ngriti zërin fuqishëm kundër shkeljes së të drejtave tona, rreshtimit dhe persekutimit nga regjimi serbo-jugosllav", tha Haxhiu.

Tutje, kryeparlamentarja theksoi se Engel i përkiste një brezi politikanësh që e kuptonin shërbimin publik si detyrë morale dhe jo si privilegj. "Në vitet e errëta, kur shqiptarët e Kosovës po vuanin nën regjimin e Slobodan Milosheviqit, e bota ende hezitonte të vepronte,

Eliot Engel ngriti zërin", u shpreh ajo.

Kryetarja Haxhiu shtoi se, kur ke miq si Eliot Engel, hapja e dyerve të botës bëhet e mundshme dhe historike. "Në shumë raste, ato dyer mbeten të mbyllura derisa bëhet vonë. Rajoni ynë e njeh mirë këtë pritje. Por, kur ke miq si Eliot Engel, hapja e tyre është e mundshme dhe historike", tha ajo.

Në vijim të seancës, një fjalë rasti mbajti kryeministri Albin Kurti, duke e nisur me një citat nga fjalimi i kongresistit amerikan më 10 shkurt 1999, në takimin e Komitetit për Marrëdhënie Ndërkombëtare: "Unë besoj që zgjidhja e vetme për Kosovën është pavarësia. Më lejoni t'ju tregoj se i them Kosova, sepse 90 për qind e njerëzve që jetojnë aty i thonë Kosova, prandaj po e përdor 'a'-në. Pavarësia dhe vetëvendosja është e vetmja zgjidhje afatgjatë. Shqiptarët e Kosovës kurrë nuk do të trajtohen drejt nën Serbi dhe kjo është dëshmuar shumë herë. Mendoj se politika jonë është mjaft e mangët, sepse për aq kohë sa e shohim Millosheviqin si pjesë të zgjidhjes pa e kuptuar se ai është problemi e jo zgjidhja, çdo zgjidhje që e përfshin atë është e destinuar të dështojë".

Këtë qëndrim të kongresistit amerikan, kryeministri Kurti e cilësoi të prerë dhe të guximshëm, që, sipas tij, njihje



realitetin, nevojat e kohës dhe përfaqësonte një vizion të kthjellët e largpamës. "Ai nuk u kursye asnjëherë në angazhimin e tij, duke e ngritur dhe duke avokuar për mbrojtjen e çështjes sonë në institucionet më të larta amerikane. Në shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë, në këtë foltore, në Kuvendin e shtetit për të cilin ai ishte i bindur se do të bëhej, ai tha: 'Dua ta shoh Kosovën të njohur nga çdo shtet në botë; dua ta shoh në BE, në NATO dhe në Kombet e Bashkuara'. Pra, ai donte për ne atë që duam për vetë", tha Kurti.

Më pas, nga një fjalë rasti mbajtën përfaqësuesit e partive parlamentare. Deputetja Liza Gashi nga Lëvizja Vetëvendosje tha se sot po nderohet njeriu që kontribuoi që qytetarët e Kosovës të jetojnë dhe të flasin lirshëm. "Për

Kosovën Eliot Engel nuk ishte vetëm një mik i madh në Kongresin amerikan, ai e kuptoi drejtë dhimbjen tonë, e mbrojti të drejtën tonë për liri dhe qëndroi pranë nesh kur rruga drejt shtetësisë dukej shumë e gjatë dhe e vështirë", tha Gashi. Në emër të PDK-së, një fjalë rasti mbajti nënkryetarja e Kuvendit Vlora Çitaku, e cila, duke vlerësuar lart angazhimin e kongresistit amerikan për Kosovën, tha se ai bëri atë që shumë pak njerëz e bëjnë në politikë. "Ai la gjurmë në ndërgjegjen e njerëzve, sepse kur një popull i vogël dëgohet pa qenë i pranishëm, kur historia e tij rrëfëhet me ndershmëri dhe bindje, atëherë ajo histori ka gjetur një zë të vërtetë - e ai ishte Eliot Engel", tha Çitaku.

Ndërsa në emër të LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu e cilësoi

kongresistin Engel si një zë të fuqishëm të lirisë së Kosovës në momentet më të vështira historike. "Në vitet më vendimtare të fatit të popullit tonë, kongresmeni Engel ishte një mbështetës i palëkundur dhe një zë i vendosur në mbrojtje të së drejtës së Kosovës për liri dhe demokraci. Kur e vërteta për vendin tonë kishte nevojë të dëgjohej, ai ishte ndër ata që e ngritën me guxim në zemër të politikës amerikane", tha ajo.

Artan Asllani nga Grupi Multietnik, në fjalën e tij, tha se në kohën kur Kosova po kalonte ditë të vështira, pati njerëz që nuk qëndruan indiferentë - dhe një prej tyre ishte Eliot Engel. "Ai nuk ishte vetëm një zë në Kongresin amerikan; ai ishte një ndër të rrallët që pa dhimbjen tonë, në një kohë kur shumëkush hezitonte ta shihte", tha Asllani.

Seanca u përmbyll me fjalimin e deputetit Besnik Tahiri nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i cili theksoi se mirënjohja dhe respekti për miqtë e vendit janë ndër vlerat më të rëndësishme të kombit shqiptar. "Kuvendi po merr një vendim historik duke nderuar dhe përkujtuar Eliot Engel. Ky është më shumë se një moment kujtese; është një shprehje e qartë e mirënjohjes sonë si shtet për një njeri që qëndroi me popullin e Kosovës në kohët tona më të vështira", tha Tahiri.

SULMI NË BANJSKË: SPASOJEVIQ DHE TOLLIQ DËNOHEN ME BURGIM TË PËRJETSHËM, MAKSIMOVIQ ME 30 VJET

PRISHTINË, 24 PRILL - Bllagoje Spasojeviq dhe Vladimir Tolliq u dënuan me burgim të përjetshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për sulmin e armatosur në Banjaskë, ndërkaq Dushan Maksimoviq u dënua me 30 vjet burgim.

Në shpalljen e aktgjykimit për sulmin në Banjaskë të Zveçanit më 24 shtator 2023, kur u vra rreshteri i Policisë së Kosovës Afrim Bunjaku, i pranishëm ishte vetëm Dushan Maksimoviq. Gjykatësi Ngadhnjim Arni tha se të tre janë fajtorë dhe duke lexuar vendimin e gjykatës, ai tha se qëllimi i grupit të armatosur në Banjaskë, ishte destabilizimi i strukturave themelore të Kosovës. "Përmes planit të mirëorganizuar, kanë tentuar që të shpërbënin pjesën veriore të territorit të Kosovës dhe këtë pjesë t'ia bashkojë Serbisë", tha ai.

Pas shpalljes së aktgjykimit, prokurori special, Naim Abazi, tha se vendimi është i mangët, pasi në të nuk është përfshirë edhe pjesa tjetër e të akuzuarve, përfshirë edhe Millan Radoiq, por shtoi se Prokuroria po bën të gjitha përpjekjet që ata të sillen para drejtësisë.

Ai u pyet se si synon Prokuroria Speciale të sjellë para drejtësisë të akuzuarin kryesor, Millan Radoiq, dhe Abazi tha se do të shfrytëzohen mekanizmat ndërkombëtarë, sikurse INTERPOL-i.

Ushtuesja e detyrës së presidentit dhe njëherësh edhe kryeparlamentare, Albulena Haxhiu, ka thënë se me këtë vendim foli rendi kushtetues i Kosovës, të cilin rreshteri Afrim Bunjaku e mbrojti deri në fund. "Ky vendim është dëshmi se sulmi ndaj Policisë së Kosovës, ndaj rendit kushtetues dhe ndaj sigurisë së vendit tonë nuk do të mbetet pa ndëshkim. Megjithatë, drejtësia për sulmin terrorist në Banjaskë nuk përfundon këtu. Ajo përmbyllet vetëm kur të gjithë përgjegjësit në krye me terroristin Millan Radoiq të dalin para drejtësisë. Lavdi Afrim Bunjakut, heroit tonë!", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se vendimi i gjykatës do të duhej të ishte "dënim maksimal për të gjithë të përfshirët". Megjithatë, ai tha se vendimi i Gjykatës Themelore është mesazh i qartë



se "kushdo që cenon Republikën e Kosovës dhe Policinë e saj, do të përballet me drejtësinë".

Sipas Prokurorisë, të akuzuarit dyshohet se, përmes përdorimit të dhunës dhe armatimit të rëndë, kishin tentuar ta shpërbënin pjesën veriore të Kosovës, për t'ia bashkuar Serbisë, me ç'rast ishte vrarë polici Bunjaku, ishte plagosur nga armë zjarri polici tjetër Alban Rashiti, ndërsa ishin lënduar policët Çlirim Sahiti, Mirsad Kryeziu dhe Sedat Dushi, por ishte rrezikuar edhe jeta e

policëve të tjerë dhe e popullatës civile.

Për këto veprime, të njëjtit akuzohen për kryerjen e veprës penale "Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës".

I akuzuari si udhëheqës i të dyshuarve për sulmin në Banjaskë, Radoiq, dyshohet se nga viti 2017 deri më 24 shtator 2023 ka siguruar të ardhura përmes një grupi të strukturuar, për t'i përdorur për armatim, logjistikë dhe financim të pjesëtarëve, me qëllim kryerjen e

veprave terroriste. Për këto veprime të dyshuara, ai akuzohet për lehtësim dhe financim të terrorizmit.

Po ashtu, sipas Prokurorisë, dyshohet se, me ndihmën e njërit nga të akuzuarit, Radulle Steviq, si dhe bizneseve të tij, Radoiq ka konvertuar të ardhura nga aktiviteti kriminal në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, duke i transferuar edhe te persona të tretë, për të fshehur origjinën e tyre. Për këtë pjesë, ai akuzohet për shpëlarje parash.

67.1% më shumë denoncime, ATK-ja intensifikon luftën kundër evazionit tatimor

PRISHTINË, 24 PRILL - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar mbi rezultatet e arritura falë denoncimeve të qytetarëve dhe veprimeve të ndërmarra në terren, në kuadër të luftimit të ekonomisë joformale dhe rritjes së disiplinës tatimore. Përmes, një komunikate për

media bëhet e ditur se gjatë periudhës raportuese janë pranuar gjithsej 924 denoncime, që paraqet një rritje prej 67.1% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Këto denoncime kanë shërbyer si bazë për ndërmarrjen e aktiviteteve inspektuese dhe

verifikuese.

Si rezultat i këtyre veprimeve, janë shqiptuar 269 gjoba, me një vlerë totale prej rreth 130,316 euro. Veprimet e ATK-së kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe në rritjen e transparencës financiare. Si rezultat, janë deklaruar rreth 396,127 euro qarkullim, si dhe 29,254 euro

Tatim mbi Vlerën e Shtuar.

Në aspektin social, aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në formalizimin e tregut të punës, ku janë regjistruar 76 punëtorë. ATK inkurajon të gjithë qytetarët që të vazhdojnë të raportojnë parregullsitë përmes kanaleve zyrtare: Autoriteti tatimor mbetet i përkushtuar



për ndërtimin e një sistemi tatimor të drejtë, transparent dhe të barabartë për të gjithë.

KUVENDI MIRATON MARRËVESHJEN PËR PROGRAMIN IPA 2020



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 PRILL - Me 93 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, është votuar projektligji për ratifikimin e Amendamentit Nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka prezantuar projektligjin dhe shpjegoi arsyet e ndryshimeve në marrëveshje. "Qëllimi i amendamentimit të kësaj marrëveshje është zgjatja e afatit kohor për kontraktimin e

projekteve edhe për tre vite shtesë. Kjo kohë është e nevojshme, pasi nga vonesat një nga projektet ka mbetur pa u kontraktuar. Afati kontraktual i projekteve të IPA 2020 ka qenë tre vite nga hyrja në fuqi e marrëveshjes financiare origjinale, të nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, përkatësisht më 3 shtator 2024. Projekti i ndikuar nga ky amendament është projekti i ngrohjes qendrore të Prishtinës, me vlerë prej 17.6 milionë euro, të cilat ofrohen si grant nga fondet IPA", tha ai.

Deputeti i Partisë Demokratike të

Kosovës, Bedri Hamza, ngriti shqetësime lidhur me nivelin e shpenzimit të mjeteve. "Qeveria e Republikës së Kosovës besoj që duhet të gjejë mënyrën se si ta rregullojë shpenzimin më të shpejtë të këtyre mjeteve. Nëse i referohemi raporteve, del që shpenzimi nga ky financim është në nivele mjaft të ulëta. E kuptoj kompleksitetin e procedurave, por megjithatë ne duhet të ndërtojmë kapacitete shtesë, të reja, qofshin ato brenda Kryeministrisë apo Ministrisë së Financave. Aktualisht, siç është dhe siç ka qenë, gjithmonë ka pasur vështirësi në shfrytëzimin e këtyre mjeteve. Dhe për ta përfunduar, realisht po, këto

kanë qenë mjete të ndikuara nga masat e Bashkimit Evropian, mirëpo shtrohet edhe pyetja: a kemi pasur faj pse janë këto masa dhe pse i humbëm dy vjet? Përndryshe, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë marrëveshje dhe sigurisht se do t'i mbështesë edhe marrëveshjet tjera që kërkojnë dy të tretat e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse janë në interes dhe dobi të Kosovës dhe qytetarëve të saj", tha Hamza. Shefja e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Jehona Lushaku-Sadriu, konfirmoi mbështetjen e subjektit të saj për marrëveshjen në fjalë. "Normalisht

se LDK-ja ka mbështetur të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë në interes të qytetarëve, posaçërisht këto që janë asistencë për projektet zhvillimore dhe komunale në Kosovë", tha ajo.

Deputetja nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Time Kadrijaj, gjithashtu shprehu mbështetjen e partisë së saj. "Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ashtu siç është deklaruar prej fillimit, do t'i përkrahë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare. Normalisht që edhe në komisionin parlamentar e kemi përkrahur këtë marrëveshje dhe do ta përkrahim edhe sot", tha ajo.

OEK-u dhe Komuna e Pejës nënshkruajnë memorandum për forcimin e bashkëpunimit ekonomik

PRISHTINË, 24 PRILL - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ku u nënshkrua memorandum i mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve.

Ky memorandum synon forcimin e bashkëpunimit institucional, mbështetjen e bizneseve lokale, përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe rritjen e konkurrueshmërisë

përmes projekteve të përbashkëta në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Bashkëpunimi parashih shkëmbim të informacionit dhe përvojave, zhvillim të projekteve të përbashkëta, organizim të aktiviteteve profesionale si konferenca dhe seminare, si dhe mbështetje në aplikime për projekte dhe fonde ndërkombëtare.

Po ashtu, parashikohet organizimi i takimeve B2B,

misioneve afariste dhe vizitave në ndërmarrje, me qëllim lidhjen e bizneseve vendore me ato ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Komuna e Pejës do të ofrojë hapësirë për zyrën e OEK-ut në Pejë, për të lehtësuar qasjen e bizneseve në shërbimet e Odës.

Oda Ekonomike e Kosovës mbetet e përkushtuar në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe forcimin e partneritetit me institucionet dhe sektorin privat.



FUSHATAT E XHON KANTAKUZENIT KUNDËR SHQIPTARËVE

Tipik për shumë prej referencave të shkurtra për shqiptarë në kronikat bizantine, është teksti i mëposhtëm i perandorit bizantin Xhon VI Kantakuzeni (John VI Kantakouzenos, 1347-1355), Historia e të cilit mbulon vitet 1320-1356. Këtu, si edhe në tekste të tjera, fiset shqiptare përshkruhen si nomadë të egër dhe të pabindur, që jetonin në zona malore gjatë muajve të verës dhe migronin në ultësira gjatë dimrit.

Nga: Xhon KANTAKUZENI
Përgatiti dhe përktheu në anglisht
(nga gjermanishtja): Robert
Elsie[1] (1328, 1332, 1336: John
Cantacuzene: *Unruly Nomads Pay
Homage to the Emperor*)
Përktheu në shqip (nga
anglishtja): Agron SHALA

Ndërsa perandori po kalonte rreth tetë ditë në Ahrid (Ohër), nomadët shqiptarë që jetonin në rajonin e Deabolisit (Devoll) u paraqitën para tij, ashtu si edhe ata nga Koloneia (Kolonja) dhe ata nga rrethinat e Ohrit.[2] Ata i bënë homazh perandorit dhe i ofruan me dëshirë shërbimet e tyre. Ata që jetonin më larg, në kufijtë e Perandorisë Bizantine, u urdhëruan me letra nga perandori të nxitonin drejt Selanikut për të bërë homazh, gjë që e bënë pak më vonë.

Ndërsa perandori po qëndronte në Thesali,[3] shqiptarët e pabindur që jetonin në malet e Thesalisë u paraqitën para tij, të cilët, sipas prijësve të tyre fisnorë, quhen malakasianë, bujanë dhe mesaritë dhe numri i të cilëve arrin në 12 mijë. Ata i bënë homazh perandorit dhe premtuan t'i shërbenin, pasi kishin frikë se do të shfaroseshin nga bizantinët me fillimin e dimrit, duke qenë se jetonin jo në qytete, por në male dhe në zona të paarrishme. Meqenëse duhet t'i braktisin këto rajone gjatë dimrit për shkak të ftohtit dhe borës, e cila bie në sasi të jashtëzakonshme në këto zona, ata besonin se do të binin lehtësisht pre e tyre.

Pak kohë më pas, guvernatorët e pjesëve perëndimore të perandorisë raportuan se nomadët shqiptarë nga Balagrada (Berati) dhe Kanina,[4] të cilët ngrihen shpejt në armë dhe janë të paqetë nga natyra, kishin shkelur traktatet me perandorin, duke sulmuar dhe plaçkitur në mënyrë të egër qytetet atje. Ata kishin guxuar të bënin të njëjtën gjë edhe më herët, kur një numër i madh njerëzish u bashkuan dhe plaçkitën qytetet, derisa perandori dërgoi një ushtri kundër tyre, duke i detyruar të qetësoheshin dhe të mos u shkaktonin më padrejtësi banorëve të qyteteve të Perëndimit.

Por, kur erdhi vera, sapo ushtria e perandorit u shpërnda dhe ushtarët u kthyen në shtëpitë e veta, ata nuk mund të mbareshin më nën kontroll dhe filluan të shkatërronin qytetet

me plaçkitje dhe sulme të hapura. Tani, shumë prej tyre u bashkuan dhe shkaktuan shkatërrime të mëdha në Berat, Kaninë, Kleisurë (Këlcyrë) dhe në një fortesë të quajtur Skreparion (Skrapar). Pas sulmeve të përsëritura, ata pushtuan edhe Timorosin (Tomori), një fortesë në perëndim të vendit jo larg Beratit, dhe u fortifikuan në të. Për këto arsye, perandori vendosi të ndërmarre një fushatë kundër tyre.[5]

Meqenëse Duka Xhon,[6] sundimtari i Akarnanisë, veçse kishte vdekur në atë kohë, perandori nxitoi të arrinte në Perëndim, pasi shpresonte ta vinte Akarnaninë nën kontrollin e tij. Gjatë përgatitjeve, ai mendoi se ishte ide e mirë të sillte një forcë ndihmëse këmbësorësh turq nga Jonia për të shtypur shqiptarët. Meqenëse këta të fundit jetojnë në zona malore të larta dhe të paarrishme, me shumë shtigje të fshehta dhe strehime, ata nuk mund të mposhten nga kalorësia, sidomos pasi në verë ngjiten në majat e maleve ku, për shkak të terrenit natyror, edhe këmbësorët e kanë të vështirë, pasi mbrojtësit mund të qëllonin nga lart. Prandaj, ai dërgoi një emisar tek Umuri[7] dhe kërkoi një forcë ndihmëse këmbësorësh. Umuri i priti me kënaqësi përfaqësuesit e perandorit, pasi e konsideronte nder të bënte diçka për të dhe i dërgoi menjëherë trupat në Selanik.

Pak më vonë, vetë perandori arriti atje me forcat e tij bizantine, mori me vete aleatët turq dhe marshoi përmes Thesalisë kundër shqiptarëve. Duke shkatërruar tokat e tyre, ai përparoi deri në Epidamnos (Durrës) dhe shumë shqiptarë u vranë. Kur morën vesh për përparimin e perandorit, duke supozuar se ushtria e tij përbëhej vetëm nga kalorësia bizantine, ata u tërhoqën në male dhe në zonat e tyre të paarrishme, duke besuar se kështu do t'i shpëtonin shfarosjes. Megjithatë, ata u sulmuar nga forcat e lehta turke dhe nga harkëtarët, të cilët veprojnë në mënyrë të lakmueshme në zona të vështira, dhe u mundën lehtësisht, jo vetëm sepse ishin të paarmatosur, por edhe sepse u kapën në panik nga sulmi i papritur i barbarëve.

Shumë shqiptarë u vranë ose u zunë robër. Ata që arritën të shpëtonin lanë pas gratë,



fëmijët dhe pasuritë e tyre dhe u strehuan në zona të largëta. Turqit i skllavëruan gratë dhe fëmijët e tyre, megjithëse anëtarë të tjerë të fiseve të tyre, që mbanin marrëdhënie të mira me perandorin, arritën të shpëtonin disa prej tyre duke i marr me haraç nga turqit. Edhe vetë perandori lejoi që për shumë prej tyre të merrej haraçi, kur të afërmit e tyre erdhën tek ai dhe iu lutën për lirin e tyre. Madje, ai do të kishte lejuar haraçin për edhe më shumë, madje të gjithë, po të kishin ardhur në kohë ndërsa turqit ishin ende nën komandën e tij. Por, meqenëse kërkuesit erdhën pas largimit të turqve, ai mundi të shpëtonte vetëm një pjesë të robërve. Shumica e tyre u dërguan në Lindje si skllavër.

Vetë bizantinët nuk i skllavërojnë njerëzit. Nuk u lejohet ta bëjnë këtë, përveç nëse janë barbarë që refuzojnë të besojnë në shpëtimin e Krishtit, Shpëtimtarit tonë. Megjithatë, ata morën në zotërim tufa të panumërta bagëtish, për të mos përmendur shumë pajisje shtëpiake dhe sende të tjera. Madje u tha, dhe raportet u vërtetuan më pas, pasi të prekurit nga fatkeqësia iu drejtuan perandorit dhe i paraqitën humbjet e tyre, se forcat bizantine kishin kapur treqind mijë krerë bagëti, pesë mijë kuaj dhe një milion e dyqind mijë krerë dele.

Ushtarët, sigurisht, nuk ishin në gjendje të merrnin me vete aq shumë kafshë, prandaj thjesht i dëbuan pronarët dhe i lanë kafshët pa barinj, në mëshirë të fatit. Banorët e qyteteve që më

parë ishin plaçkitur nga shqiptarët dolën dhe morën në zotërim aq kafshë sa dëshironin, pa i ndaluar askush. Edhe pronarët e mëparshëm, pasi kishin premtuar nënshtrim dhe besnikëri ndaj perandorit, u lejuan të rimerrnin shumë nga kafshët që i gjenin duke bredhur lirshëm në gryka dhe lugina. Ata gjithashtu blenë shumë kafshë nga ushtarët, të cilët kërkonin një monedhë ari për çdo pesëqind krerë dele ose për çdo njëqind krerë bagëti.

Megjithëse ndër trupat më parë ishte zakoni që të lihej mënjane një e pesta e plaçkës, qoftë e madhe apo e vogël, si tribut për perandorin, dhe një pjesë e barabartë për prijësin e madh (Domestikos), i cili ishte komandanti i përgjithshëm i gjithë ushtrisë, pothuajse askush nuk merrej me këtë zakon dhe askush nuk i detyronte ushtarët të ndanin një të pestën e fitimeve. Atyre u lejohej të merrnin sa të donin nga plaçka, sikur ajo të rridhte lirshëm në sasi të pakufishme. Të tilla ishin dhunimet e kryera më parë nga shqiptarët kundër banorëve të perëndimit dhe i tillë ishte ndëshkimi për padrejtësitë e tyre. Qytetet që kishin vuajtur më parë prej tyre përfituan dyfish, me gëzim të madh. Nga njëra anë, u çliruan nga sulmet shqiptare dhe, nga ana tjetër, patën mundësinë të përfitonin nga prania dhe kujdesi mbrojtës i perandorit. Për këtë arsye, ata ishin edhe më të gëzuar dhe festuan si kurrë më parë. Që nga koha e perandorit Manuel Komneni[8] deri tek ajo e perandorit

Andronik Palaeologut,[9] asnjë perandor tjetër bizantin nuk i kishte vizituar ndonjëherë dhe nuk kishte treguar një kujdes të tillë ndaj tyre. Ndërsa ai ishte aty, ata e konsideronin perandorin si një qenie të mbinatyrshme.

Pasi shqiptarët u mundën, perandori i dërgoi në shtëpi aleatët e tij turq, të cilët kaluan përmes Thesalisë dhe Botisë drejt Selanikut dhe prej andej lundruan përsëri për në Joni. /Telegrafi/

[1] Fragment nga: John Cantacuzenus: *Geschichte*, Stuttgart 1982, I, f. 190 = Lib. 1, 55, f. 279, rr. 22sq.; II, f. 107 = Lib. II, 28, f. 474, rr. 9-19; II, f. 120-123 = Book II, 32, f. 495-499. Përkthyer nga Robert Elsie. Fillimisht botuar në R. Elsie: *Early Albania, a Reader of Historical Texts*, 11th - 17th Centuries, Wiesbaden 2003, f. 14-17.

[2] Takimi vlerësohet të ketë ndodhur rreth shkurtit të vitit 1328.

[3] Mbase në fund të vjeshtës së vitit 1332.

[4] Kalaja e Kaninës ndodhet disa kilometra mbi Vlorë në bregdetin jugor të Shqipërisë.

[5] Ekspedita ndoshta u zhvillua në pranverën e vitit 1336. Kr. J. Cantacuzenus 1986, f. 232.

[6] Giovanni Orsini.

[7] Aydınoğlu Gazi Umur Bey (c. 1309-1348)

[8] Manuel I Comnenus (r. 1143-1180) vizitoi Vlorën në verën e vitit 1149.

[9] Andronicus III Palaeologus (r. 1328-1341).

MILIARDA EURO HUMBJE - PASOJAT E RËNDA PËR EUROPËN, NGA NJË LUFTË QË PO E BËJNË TË TJERËT



Evropa gjendet sërish në një udhëkryq ekonomik. Pasojat e luftës në Iran po kthehen me shpejtësi në një barrë financiare marramendëse për kontinentin, i cili sapo kishte filluar të merrte frymë pas krizës së shkaktuar nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022.

Komisioni Evropian zbuloi të mërkurën një seri masash emergjente për të mbrojtur ekonominë nga rritja e faturave të energjisë. “Për herë të dytë në më pak se pesë vjet, evropianët po paguajnë çmimin e varësisë nga lëndët djegëse fosile të importuara”, deklaroi krahu ekzekutiv i BE-së. Sipas të dhënave, blloku ka shpenzuar 24 miliardë euro (28 miliardë dollarë) shtesë vetëm nga rritja e çmimeve – rreth 587 milionë dollarë çdo ditë – pa blerë asnjë

molekulë shtesë energjie.

Masat e BE-së: Koordinim dhe ndërhyrje emergjente

Për të përballuar goditjen, BE planifikon ngritjen e një organi pan-evropian që do të identifikojë dhe koordinojë mungesat e karburantit, si dhe menaxhimin e rezervave kombëtare.

Sektori i Aviacionit në rrezik

Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe ACI Europe kanë paralajmëruar për mungesa të mundshme të karburantit të avionëve. Evropa importon rreth 70% të nevojave të saj. Grupet e industrisë kanë bërë thirrje për “pezullim urgjent të

taksave të aviacionit” për të mbajtur çmimet nën kontroll.

Goditja të bizneset e mëdha

Kompani si Lufthansa njoftuan shkurtimin e 20,000 fluturimeve deri në tetor për shkak të dyfishimit të çmimit të karburantit. Nga ana tjetër, gjiganti kimik BASF ka rritur çmimet deri në 30% për produkte jetësore, ndërsa industria kimike gjermane paralajmëron mbyllje fabrikash dhe shkurtime të vendeve të punës.

Sektorët tradicionalë

Mbijetesa po bëhet e vështirë edhe për peshkatarët. BE-ja ka aktivizuar një “mekanizëm

krize” për t’i ofruar këtij sektori mbështetje direkte financiare, pasi kostot e karburantit po pamundësojnë nxjerrjen e prodhimeve të detit në treg.

Rreziku i recesionit dhe ndikimi të konsumatorët

Neil Shearing, kryeekonomist në Capital Economics, paralajmëron se vazhdimi i luftës me Iranin në gjysmën e parë të këtij viti mund ta zhysë Evropën në recesion të plotë. Fondi Monetar Ndërkombëtar tashmë ka ulur parashikimet e rritjes ekonomike për 21 vendet e Eurozonës dhe ka rishikuar ndjeshëm në rënie zhvillimin e Mbretërisë së Bashkuar.

Në Britaninë e Madhe, inflacioni u rrit sërish këtë

muaj. Presioni i çmimeve në pompa nuk është veçse “vala e parë e shokut”, thotë ekonomisti Adam Deasy. Sipas tij, faza e dytë do të godasë nënproduktet kritike: plehrat bujqësore, plastikën dhe metalet. Situata ka prekur edhe sektorin shëndetësor dhe ushqimor me mungesa thelbësore të dioksidit të karbonit (CO₂), një nënprodukt i plehrave kimikë, tregu i të cilëve është bllokuar nga rritja e gazit.

Përballë kësaj situatë, qeveritë e Evropës, përfshirë Londrën, po nxitojnë të shtojnë kapacitetet vendase për energjinë diellore dhe të rinovueshme, një orvatje e dëshpëruar për të mbajtur “të ndezur” ekonominë e kontinentit në prag të krizës së radhës.



Zyrtare: Alban Hajdari nënshkruan kontratë të re me Hoffenheimin

HOFFENHEIM, 24 PRILL - Alban Hajdari ka nënshkruar një kontratë të re afatgjatë me TSG Hoffenheim. Klubi i Bundesligës ka konfirmuar zgjatjen e kontratës për mbrojtësin zviceran të premtën, pa zbuluar kohëzgjatjen e marrëveshjes. "Albian u bashkua me ne menjëherë pas fillimit të sezonit të kaluar verën e kaluar dhe është zhvilluar në një lojtar kyç dhe titullar të rregullt në një kohë shumë të shkurtër". "Që nga dita

e parë, ai u identifikua plotësisht me projektin tonë në TSG dhe, përmes performancave të tij, ka dhënë një kontribut të madh në sezonin tonë të suksesshëm. Vetëm 22 vjeç, ai ende ka potencial të konsiderueshëm zhvillimi. Këmba e tij e fortë e majtë, shkathtësia mbrojtëse dhe mentaliteti i shkëlqyer janë cilësitë e tij përcaktuese", ka thënë drejtori menaxhues sportiv i TSG Hoffenheim, Andreas Schicker. Hajdari, i cili i cili i është

bashkuar Hoffenheimit nga skuadra elitare zvicerane FC Lugano verën e kaluar, ka thënë se ndihet rehat në klubin gjerman. "Ndihem shumë rehat në Hoffenheim. Edhe kur u bashkova gjatë verës, e kuptova shpejt se diçka e veçantë po ndërtohet këtu. Perspektiva është e duhura dhe dua të vazhdoj të luaj rolin tim në këtë zhvillim pozitiv dhe në suksesin e Hoffenheimit", ka thënë Hajdari.



FUNDJAVË E "NXEHTË" NË ELITËN E FUTBOLLIT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 24 PRILL - Superliga e Kosovës në futboll rikthehet këtë fundjavë më ndeshjet e xhiros së 30-të. Kjo xhiro e cila pritet të sjellë disa duele të forta dhe tejet të rëndësishme nis të sot (e shtunë) pasdite me dy sfidat e para. Dueli mes Prishtinës së Re dhe Drenicës e cila nis në orën 15:00, hap ndeshjet e kësaj fundjavë. Po të njëjtën ditë, në mbrëmje nga ora 20:00, zhvillohet derbi i madh mes Prishtina dhe

Gjilani, një duel që është tejet i rëndësishëm për të dy skuadrat. Ndërsa nesër (e diel) nga orën 15:00, Drita do të jetë nikoqire e Llapi në Gjilan.

Në po të njëjtën ditë zhvillohen edhe dy përballje të tjera: Ballkani - Ferizaj dhe Dukagjini - Malisheva. Xhiroja e 30-të pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në renditjen e kampionatit, teksa skuadrat hyjnë në fazën vendimtare të sezonit.

SUPERLIGA / JAVA E 30-të

Sot:

Prishtina e Re-Drenica
Prishtina-Gjilani

Nesër

Ballkani-Ferizaj
Drita-Llapi
Dukagjini-Malisheva



ÇMENDURI E FIFA-S ME BILETAT E KUPËS SË BOTËS 2026, NJË VEND NË FINALE KUSHTON 2.3 MILIONË DOLLARË



ZURICH, 24 PRILL - Kupa e Botës 2026 do të zhvillohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada nga 11 qershori deri më 19 korrik, por që tani kanë nisur të dalin në pah çmenduria për biletat, me një të tillë që kushton pak më pak se 2.3 milionë dollarë. Portali zyrtar i rishitjes së FIFA-s po liston biletat për finalen e 19 korrikut në stadiumin "MetLife" në New Jersey për afro 2.3 milionë dollarë secila.

Katër vende në tribunën e poshtme pas njëres nga portat janë në shitje për 2 milionë e 299 mijë e 998 dollarë. Të dhënat janë të habitshme, por në përputhje të plotë me mënyrën se si funksionon sistemi. FIFA nuk vendos kufizime çmimesh në tregun sekondar, megjithëse mban një komision prej 15 për qind si nga shitësi ashtu edhe nga blerësi. Nëse shitet me atë

çmim, organi ndërkombëtar do të mbledhë afërsisht 690 mijë dollarë për biletë të vetme. Alternativat, ndonëse më të arritshme, mbeten tepër të shtrenjta, vendet e tjera në të njëjtin seksion arrijnë në 207 mijë dollarë, ndërsa në nivelin e tretë, çmimet bien në 138 mijë dollarë ose edhe 23 mijë dollarë. Biletat "më të lira" fillojnë nga pak më pak se 11 mijë dollarë.

Zhegrova dëshiron të qëndrojë te Juventusit

TORINO, 24 PRILL - E ardhmja e Edon Zhegrovës duket se do të jetë një nga temat më të diskutuara në afatin kalimtar të verës që po vjen. Ylli i Kombëtares së Kosovës e ka bërë të qartë se dëshiron të qëndrojë tek 'Zonja e Vjetër'. Sulmuesi i krahut i Dardanëve, pavarësisht një sezoni jo në nivelin e pritshmërive personale, mbetet i vendosur të provojë veten në Torino. Sipas "Calciomercato.com",

Zhegrova u ka kërkuar përfaqësuesve të tij që të pezullojnë çdo diskutim për transferim deri në përfundim të sezonit aktual. Ky qëndrim interpretohet si një shenjë e qartë e ambicies së tij për të fituar më shumë minuta dhe për të bindur stafin teknik për rolin e tij në skuadër. Megjithatë, situata mbetet e hapur nga ana e klubit. Drejtuesit e Juventusit nuk e përjashtojnë mundësinë e

shitjes, nëse mbërrin një ofertë e kënaqshme, me vlerën e kartonit të lojtarit që vlerësohet rreth 11-12 milionë euro. Objektivi i klubit është të ruajë ekuilibrin financiar, duke shmangur humbje të mundshme. Në javët në vijim pritet të ketë zhvillime të reja, por aktualisht mesazhi i Zhegrovës është i prerë: ai synon të qëndrojë te Juventusit dhe të luftojë për një vend të rëndësishëm në skuadër.





Ndërmarrja Publike Lokale
KASTRIOTI Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 4666607; +383 48777624
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com



Obiliq

Nr. i Prot.: I-703/26
Data: 24.04.2026

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, nenit 7, dhe nenin 12 par. 2 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 11.03.2024, nenit 18 dhe nenit 22 të Rregullores Nr. 1-547 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punëve miratuar me datë 31.03.2026 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Kastrioti" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit I-702/26 të datës 24.04.2026 të U.D të Kryeshefit Ekzekutiv – Flakron Mjekiqi, N.P.L "Kastrioti" Sh. A, me datë 24.04.2026, shpall:

KONKURS PUBLIK TË JASHTËM

I. Titulli: Drejtor i Administratës

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare

Përvoja e punës: Preferohet dy (2) vite

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Koeficienti i pagës: 700.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Udhëheqë, mbikëqyrë dhe koordinon punën e Zyrtarit për Arkiv, duke u siguruar për administrimin, mbarëvajtjen e protokollit dhe menaxhimin e duhur e të sigurt të dokumentacionit e shkresave zyrtare të ndërmarrjes.
- Menaxhon dhe mbikëqyr punën e Asistentit/es Administrativ/e, duke deleguar dhe organizuar detyrat e përditshme për mbarëvajtjen efikase të proceseve administrative në zyrë.
- Mbikëqyrë drejtpërdrejt Zyrtarin përgjegjës për marketing, Zyrtarin për Media dhe Punëtorin për fotografi, video dhe montazhë, duke koordinuar fushatat informuese, përgatitjen e materialeve vizuale për rrjetet sociale (Facebook, uebfaqe) dhe komunikimin me mediat.
- Koordinon aktivitetet e Zyrtarit për Marrëdhënie me Klient për t'u siguruar që kërkesat, ankesat dhe informimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit të trajtohen në mënyrë profesionale dhe në kohë.
- Analizon dhe vlerëson vazhdimisht proceset e brendshme të këtyre zyrave, duke propozuar masa për rritjen e efikasitetit.
- Koordinon punën e Zyrtarit për mjedis, duke ndihmuar në planifikimin e masave, fushatave vetëdijësuese dhe planeve të punës për mbrojtjen e mjedisit në nivelin e shërbimeve publike.
- Përgatit raporte të rregullta periodike (javore, mujore, vjetore) për të gjitha njësitë dhe zyrtarët që ka nën menaxhim.
- Për punën që kryen, i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Kastrioti" Sh. A - Obiliq. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

- Intervista me gojë deri në shtatëdhjetë (70) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në tridhjetë (30) pikë.

II. Titulli: Zyrtar Ligjor

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Fakulteti Juridik

Përvoja e punës: Preferohet dy (2) vite

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Koeficienti i pagës: 570.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identikë në tri gjuhët zyrtare;
- Sipas kërkesës ose udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bënë hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
- Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislationit;

- Kryen edhe punë të tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.
- Përgatitë dhe administron dokumentacionin juridik-ligjor në Zyrën Ligjore.
- Përpilon shkresa procedurale në të gjitha fazat deri në finalizimin e proceseve përbarimore, gjyqësore dhe përfaqësimi i ndërmarrjes në çështjet e caktuara juridike: tek përbaruesit privat, gjykata dhe organet tjera relevante.
- Zbaton planet vepruese të përcaktuara nga përgjegjësi.
- Të përfaqësojë ndërmarrjen në konteste me inspektoratin e punës.
- Të ndihmojë gjatë procesit të punës Zyrtarin e Burimeve Njerëzore.
- Për punën që kryen i përgjigjet Sekretarit dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Kastrioti" Sh. A - Obiliq. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

III. Titulli: Asistent Administrativ

Numri i ekzekutuesve: 4

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare apo shkollim i mesëm

Përvoja e punës: E preferuar një (1) vit

I raporton: Drejtor i Administratës

Koeficienti i pagës: 444.45 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që të kryej detyrat e punës pa kufizime, të mbajë librin e protokollit;
- Të bëjë pranimin e dokumentacionit dhe shkresave, dhe të tillat t'i shpërndajë nëpër zyrat përkatëse.
- Të mbajë librin e dorëzimit dhe pranimin të postës si dhe të shpërndajë dokumentet nëpër zyre përkatëse, shpërndajë materialet e ardhura me postë sipas klasifikimit.
- Të bëjë menaxhimin dhe kryen procesin e skanimit të të gjitha dokumenteve të rëndësishme në ndërmarrje dhe bënë sistemimin e tyre nëpër dosje, asiston dhe siguron të gjithë dokumentacionin në bazë të kërkesave nga departamentet tjera.
- Mban evidencë administrative të librave (regjistrat, listat, inventarin);
- Regjistron huazon kthimet;
- Kohë pas kohe merret në mënyrë të pavarur me çështje që nuk janë paraparë në udhëzime të punës, por janë të ndërlihdura me nevojat e Ndërmarrjes;
- Ndihmon në organizimin e aktiviteteve kulturore (sallën);
- Pranon dhe raporton cdo kërkesë të personat përgjegjës
- Sistemon dokumentacionin civile juridik që ndërlihdet me punën e ndërmarrjes.
- Për punën që kryen i përgjigjet Drejtorit të Administratës.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Kastrioti" Sh. A - Obiliq. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

IV. Titulli: Zyrtar i Kontabilitetit

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Fakulteti ekonomik - Banka, financa dhe kontabilitet, përparësi me studimet master të përfunduar

Përvoja e punës: Së paku një (1) vit;

I raporton: Për punën e saj i përgjigjet drejtpërdrejtë Zyrtares Kryesore Financiare

Koeficienti i pagës: 545.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bënë pranimin dhe sistemimin e dokumentacionit kontabël për departamentin e financave;
- Bënë regjistrimin e dokumentacionit kontabël të pranuar: faturat e blerjes, faturat e shpenzimeve, faturat e shitjes etj.;
- Bënë vendosjen e dokumenteve në regjistrator dhe bënë mirëmbajtjen e rregullt të regjistratorëve sipas llojit të dokumentacionit kontabël;

- Përgatitjen e regjistrimit (kartelave) të detyrimeve për pagesë me detajet e koordinatoreve dhe përcjellja e kryerjes me kohë të të gjitha detyrimeve;
- Bën deklaratimet vjetore të ndërmarrjes;
- Bën kontrollimin e regjistrimit në programin e shitjes;
- Mbron vlerën e organizatës duke ruajtur informacionin konfidencial;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave të menaxhmentit;
- Bën dhe kryen punë tjera nga lëmi i kontabilitetit, financave ose punë të tjera administrative sipas kërkesës së ZKF-së dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
- Për punën e saj i përgjigjet drejtpërdrejtë Zyrtares Kryesore Financiare.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Kastrioti" Sh. A - Obiliq. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

> Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

> Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

> Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

> Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 27.04.2026 deri me datë 12.05.2026 ora 16:00.

Arsyeja pse konkursi publik i jashtëm pse mbyllet me datë 12.05.2026, e jo me datë 11.05.2026, qëndron tek neni 81 par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku thuhet si në vijim:

Mbyllja e konkursit të jashtëm publik më datë 12.05.2026, në vend të datës 11.05.2026, mbështetet në nenin 81, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku thuhet si në vijim: "4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk do të pengojnë fillimin dhe ecjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj.", çka data 11.05.2026 ishte ditë e festës zyrtare, afati është shtyrë për datën 12.05.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 19.05.2026.
- Afati për ankesë nga data 20.05.2026 deri me datë 22.05.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 02.06.2026.
- Afati për ankesë nga data 03.06.2026 deri me datë 05.06.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 08.06.2026.
- Afati për ankesë nga data 09.06.2026 deri me datë 11.06.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatit dhe suksesshëm është më së largu 16.06.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

> Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: konkursetnplkastrioti@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

> Sqarim


Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

> Përfundim

N.P.L. "Kastrioti" Sh. A në Obiliq ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



Ndërmarrja Publike Lokale
KASTRIOTI Sh.A.
Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 46666607; +383 48777624
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com



Na osnovu člana 8. i člana 10. podstav 2.2 Zakona o radu br. 03/L-212, objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, člana 7. i člana 12. stav 2. Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 o regulisanju konkursnih procedura u javnom sektoru, koje je deo Zakona o radu br. 03/L-212, objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 11.03.2024. godine, člana 18. i člana 22. Pravilnika br. I-547 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta, usvojenog dana 31.03.2026. godine od strane Odbora direktora N.P.L. „Kastrioti“ Sh.A., a oslanjajući se na odluku sa br. protokola I-702/26 od 24.04.2026. godine, v.d. Glavnog izvršnog direktora – Flakrona Mjekijija, N.P.L. „Kastrioti“ Sh.A., dana 24.04.2026. godine, objavljuje:

SPOLJNI JAVNI KONKURS

I. Naziv radnog mjesta: Direktor administracije

Broj izvršilaca: 1

Radno vrijeme: 40 sati nedeljno

Trajanje radnog odnosa: Na određeno vrijeme od jedne (1) godine, od čega je šest (6) meseci probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna sprema: Univerzitetsko obrazovanje (Visoka stručna sprema)

